

**NJOFTIM PER ZHVILLIMIN E AKTIVITETIT, SUBJEKT I LEJES MJEDISORE
TIPI A OSE B DHE INFORMACION PER NDIKIMET NE MJEDIS
KLASIFIKIMI I AKTIVITETIT SIPAS LIGJIT NR. 10448, DATE 14.07.2011 "PER
LEJET E MJEDISIT", INDRYSHUAR, SHTOJCA I, PRODHIMI I USHQIMEVE
DHE PIJEVE DHE VEPRIMTARITE E LIDHURA ME TO.**

**ID. 7.7./G. PRODHIMI DHE AMBALAZHIMI I PIJEVE JOALKOLIKE
&
ID 7.13 ... PRODHIMI I PRODUKTEVE PREJ PLASTIKE**

OBJEKTI:

Prodhim ambalazhim tregtim i lengjeve te frutave, pije freskuese me gaz dhe pa gaz dhe pije energjike, si dhe Prodhimi i produkteve prej plastike

ADRESA:

Me Vendodhje: në fshatin Lajthizë, Nj. Ad Qafe-Mali, Bashkia Fushë-Arrëz, Qarku Shkoder.

ZHVILLUES:

“LAJTHIZA INVEST” SH.A

NIPT: J98009202P



Ky raport hartohet ne perputhje me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 419, date 25.6.2014 "Per miratimin e kerkesave te posaqme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A, B dhe C, per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per /ejet respektive te mjedisit, si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre /ejeve nga QKL-ja". Kreu VI, Informimi dhe pjesemarrja e publikut per ap/ikimin per /eje mjedisi te tipit A dhe B.

Mars, 2025

1. Hyrje

Ky raport hartohet me kerkese te subjektit "LAJTHIZA INVEST" sha, me seli ne: Shkoder, Fushe Arrez Stabilimenti i Prodhimit, Lajthize, Njesia Administrative Qafe Mali, dhe administrator Z. Thanas Siveri dhe NIPT: J98009202P.

Ky subjekt, paraqitet ne cilesine e subjektit investitor dhe si subjekti qe do te zhvilloje aktivitetin e Prodhimit ambalazhimit tregtimit te lengjeve te frutave, pije freskuese me gaz dhe pa gaz dhe pije energjike, si dhe Prodhimi i produkteve prej plastike, si aktivitet ne ndihme te ketij te fundit.

Objekti i vleresimit te ketij raporti eshte aktiviteti i Prodhimit ambalazhimit tregtimit te lengjeve te frutave, pije freskuese me gaz dhe pa gaz dhe pije energjike, konkretisht, te cilat jane edhe pijet tradicionale te vendit tone.

Kompania Lajthiza Invest sh.a e themeluar ne vitin 1999, ka investuar pa ndërprerje në një zonë të thellë malore në Veri-Lindje të Shqipërisë, në fshatin Lajthizë, Pukë, Bashkia Fushë-Arrëz me fabrikën e saj të prodhimit dhe ambalazhimit të ujit natyral, por tashme jo vetem uje mineral dhe natyral, aktiviteti do te zhvillohet ne nje objekt ekzistues, i pajisur me:

- Miratim te VNM-se Paraprake, me Nr 87 Prot, Vendim 12, date 11.11.2014.

- Certificate per Vertetim Pronesie me NR 1435599, Zk2371, Nr pasurie 340, Vol 2, Faqe 93, Lloji I mpasurise truall, me siperfaqe totale 4976 m² nga te cilat ndertese 4762 m², ne pronesi te vete shoqerise "LAJTHIZA INVEST" sha

-Leje per perdorimin e burimit uJOR nentokesor, me Nr 238 Prot, date 29.04.2021, miratuar me Vendimin e Keshillit te Basenit Ujore Drin-Bune, Nr 13, date 23.04.2021.

Teknologjia

Deri me tani shoqeria ka prodhuar vetem ujin ne paketime dhe formate te ndryshme, tashme subjekti do te shtoje edhe dy linja.

- **Linjen e prodhimit te pijeve freskuese (joalkolike, te lengjeve te frutave) me gaz edhe pa gaz, si edhe ate te pijeve energjike, si dhe**
- **Linjen e prodhimit te plastikës, ky i fundit si aktivitet ne funksion te atij te prodhimit te pijeve , me qellim ambalazhimit dhe tregtimin e tyre.**

Shtojca 2

Fabrika e ujit natyral Lajthiza është ndërtuar në lartësinë 1200 m mbi nivelin e detit, ndërsa burimi rrjedh nga një masiv malor 1600 m mbi nivelin e detit, me një strukturë shkëmbore magmatike. Burimi Natyror i Ujit klasifikohet si Ujë – i pasur dhe i balancuar me minerale dhe bakteriologjikisht I certifikuar dhe me cilësi të veçanta për shëndetin.


2. Adresa e vendndodhjes se instalimit

Aktiviteti do të zhvillohet ne nje objekt ekzistues, i pajisur me Miratim te VNM-se Paraprake, me Nr 87 Prot, Vendim 12, date 11.11.2014. dhe Certifikaten per Vertetim Pronesie me NR 1435599, Zk2371, Nr pasurie 340, Vol 2, Faqe 93, Lloji I mpasurise truall, me siperfaqe totale 4976 m2 nga te cilat ndertese 4762 m2, ne pronesi te vete shoqerise "LAJTHIZA INVEST" sha me Vendodhje : në fshatin Lajthizë, Nj.Ad Qafe-Mali, Bashkia Fushë-Arrëz, Qarku Shkoder.




Pamje 3d e vendodhjes se aktivitetit te Lajthizes

Shtojca 2



Ortofoto



Harte Topografike

Koordinatat ne sistemin KRRGJSH

Nr	X	Y
1	512073	4661492

Shtojca 2

Nje pershkrim te elementeve te listuara ne formularin informues

informacion mbi kërkuesin/operatorin

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Emri i Kompanisë	“Lajthiza Invest” sh.a
Statusi Ligjor	aktiv
Ortakët/Aksionerët e Kompanisë(sipas Ekstraktit të lëshuar nga QKR)	Kryetar: Rushit Elezaj, Antar: Lavdije Elezaj, Antar: Sonila Elezaj
Adresa e zyrës qendrore të Kompanisë	Shkoder Fushe Arrez, Stabilimenti i Prodhimit, Lajthize, Njesia Administrative Qafe Mali, Bashkia Fushe- Arrez
Adresa postale e Kompanisë, nqse ndryshon nga adresa e mësipërme	Shkoder Fushe Arrez, Stabilimenti i Prodhimit, Lajthize, Njesia Administrative Qafe Mali, Bashkia Fushe- Arrez
Numri i rregjistrimit të Kompanisë(NIPT)	J98009202P
Kodi kryesor i aktivitetit (sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit nr 10448, date 14.7.2011 “Per lejet e mjedisit”)	Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to, - ID 7.7/g - Prodhim dhe ambalazhim i pijeve joalkoolike (përveç ujit). Dhe Prodhimi i produkteve plastike - ID 7.13 - Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e tipit A ose tipit B të kësaj shtojce, Podhimi i produkteve prej plastike
Kodi SNAP ¹	
Kodi NOSE-P ²	
Numri i Punonjësve	10-15
Përfaqësuesi i autorizuar	Perfaqesues Ligjor
Emri dhe Mbiemri	Thanas Siveri
Pozicioni në Kompani	Administrator
Telefoni	069 203 0620
Faksi	-
E-mail	info@lajthiza.al

¹ Nomenklatura e zgjedhur për burimet e ndotjes së ajrit, të specifikuar në Aneksin 1 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedisi për kërkuesit

² Nomenklatura për burimet e shkarkimit, të specifikuar në Aneksin 1 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedisi për kërkuesit

Shtojca 2

INFORMACION MBI INSTALIMIN/IMPIANTIN

Emri i instalimit/impianit ³	<p>Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to, - ID 7.7/g - Prodhim dhe ambalazhim i pijeve joalkoolike (përveç ujit). Dhe Prodhimi i produkteve plastike - ID 7.13- Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e tipit A ose tipit B të kësaj shtojce, prodhimi i produkteve prej plastike</p>						
Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianiti	në fshatin Lajthizë, Nj.Ad Qafe-Mali, Bashkia Fushë-Arrëz, Qarku Shkoder.						
Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th style="width: 10%;">Nr</th> <th style="width: 40%;">X</th> <th style="width: 50%;">Y</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>512073</td> <td>4661492</td> </tr> </tbody> </table>	Nr	X	Y	1	512073	4661492
Nr	X	Y					
1	512073	4661492					
Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi ⁴	<p>Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to, - ID 7.7/g - Prodhim dhe ambalazhim i pijeve joalkoolike (përveç ujit). Dhe Prodhimi i produkteve plastike - ID 7.13- Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e tipit A ose tipit B të kësaj shtojce, prodhimi i produkteve prej plastike</p>						
Kapaciteti i projektuar	<p>Kapaciteti lidhur me Prodhim dhe ambalazhim i pijeve joalkoolike (përveç ujit), është ne varesi te kerkesave te klienteve Dhe Kapaciteti lidhur me prodhimin e shisheve plastike, me qellim ambalazhimin e pijeve freskuese, sikurse edhe ujit është me i madh se 50 ton/vit.</p>						

³ Përshkruaj titullin sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për Lejet e mjedisit

⁴ Shkruani kodet e specifikuar në kollonën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuar në kollonën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

Shtojca 2

Tabela në vijim përfshin listën e të gjithë lejeve, liçensave, autorizimeve të përfuara në datën e dorëzimit të Formularit të kërkesës.

Leja, Liçensa, Autorizimi	Nr. Ref.	Data e Lëshimit	Periudha e vlefshmërisë
Miratim te VNM-se Paraprake	me Nr 87 Prot, Vendim 12,	11.11.2014.	
Leje per perdorim burimi ujqor nentokesor	Nr. 238 Prot.	29/04/2021	23.04.2021 - 22.04.2026
Licence per Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve	LN-6821-01-2024	23.03.2011	

Duhet të përfshihen të gjitha lejet, liçensat, autorizimet e vlefshme në datën e dorëzimit të kërkesës.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Nr. 87 Prot.

Tiranë, më // . // . 2014

Nr. Identifikimi 103

Vendim 12

**VENDIM
PËR VNM PARAPRAK**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", , dhe VKM Nr.13, datë 04.01.2014 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis",

AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, vendosi që ky projekt **nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar** për zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:

Personi juridik: "LAJTHIZA INVEST" me LC-8282

Nr. NIPT: J98009202P

Adresa e selise: Qafa e Malit, Kukës

Personi përgjegjës: Thanas Siveri

Per te zhvilluar projektin: "**Prodhim, mbushje, ambalazhim dhe tregetim i ujit natyral mineral**".

Vendndodhja e projektit: Burimi Qafe-Mali, Rruga Nacionale Puke-Kukës, Tirane, Kukës.

Siperfaqja totale e objektit: 4 640 m²

Siperfaqja e ndertimit: 3 570 m²

Zona Kadastrale: 2371, Nr. Pas. 340

Harta Kadastrale: K - 34 - 65 (181 - D)

Sasia e prurjes: Q = 5 l/sek

Sasia e ujit ne perdorim: 2 l/sek

Ky vendim, jepet ne perputhje me "Kontraten Koncensionare per Perdorimin e ujit", lidhur midis subjektit dhe AUB Drin-Buncë, me date: 15.08.2005, me afat 30 vjecar.

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me harten topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr. Serial 000141



LEJE
PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR
Nr. 238 Prot., datë 29/04/2021

Miratuar me:
VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR DRIN-BUNË
Nr.13 , datë 23/04/2021

Emri i individit/subjektit:	LAJTHIZA INVEST SH.A
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT):	J98009202P
Baseni Ujor:	DRIN-BUNË
Qarku:	SHKODËR
Bashkia/ Njësia administrative:	FUSH ARRËS/QAF MALI
Koordinatat:	X ₁ = 510754; Y ₁ = 4658559; Z ₁ = 1175 X ₂ = 511458; Y ₂ = 4658615; Z ₂ = 1061 X ₃ = 511020; Y ₃ = 4659277; Z ₃ = 978 X ₄ = 511176; Y ₄ = 4659386; Z ₄ = 952 X ₅ = 511328; Y ₅ = 4660133; Z ₅ = 879

Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji:	AMBALAZHIM UJI
Prurja mesatare vjetore	1.5 l/s
Prurja ekologjike	nuk ka
Sasia e ujit që jepet për përdorim	1.5 l/s
Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka)	nuk ka
Vendi ku do të shkarkohet rrjedha e kthyer	nuk ka
Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: X = 512148; Y = 4661518; Z = 745	
Sipërfaqja e tokës, me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes): nuk ka (ha)	
Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka):	Sipas Kushteve të lejes.
Periudha e vlefshmërisë:	23.04.2021 - 22.04.2026
Hyrja në fuqi	23.04.2021

KRYETARI

MAJLINDA ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË RISKUT DHE
KOORDINIMIT TË KONTROLLIT ZYRTAR

Nr. 855/3 prot.

Tiranë, më 09/10.2024

Lënda: Akt miratimi

QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Tiranë

Në vijim të kërkesës LC-9389-09-2024, si dhe mbështetur në Ligjin Nr 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", Ligjin Nr.10081, datë 23.2.2009 "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin Nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar, VKM-në Nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta" i ndryshuar, për licencat e grupit të tretë (që i përkasin AKU-së); Fusha II, Ushqimi dhe Shëndeti, subjekti "LAJTHIZA INVEST", Qarku Shkodër, me NUIS/NIPT: J98009202P, numri i titullit të licencës në zotërim LN-6821-01-2024, me aktivitet: "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz", veprimtari specifike: "Prodhim, ambalazhim, tregtim uji natyral me aromë të shijeve të ndryshme, pije freskuese me gaz, pije freskuese pa gaz, pije energjike", ka aplikuar për ndryshim të përshkrimit të aktivitetit të subjektit, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB-së).

Në bazë të shkresës Nr. Prot. 2553/5, datë 02.10.2024, të Drejtorisë Rajonale të Qarkut Shkodër, paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, subjektit i është kryer inspektimi në vend, nga inspektorët e kësaj Drejtorie dhe rezulton:

Subjekti "LAJTHIZA INVEST", plotëson kushtet dhe kriteret përkatëse ligjore për zhvillimin e aktivitetit të kërkuar për licencim.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,



Shtojca 2

Informacioni mbi personin e kontaktit të autorizuar nga administratori në lidhje me lejen

Emri dhe Mbiemri	Thanas Siveri
Adresa	Shkoder Fushe Arrez, Stabilimenti i Prodhimit, Lajthize, Njesia Administrative Qafe Mali, Bashkia Fushe-Arez.
Pozicioni në kompani	Administrator
Telefoni	069 203 0620
Faksi	-
E-mail	info@lajthiza.al

Pronësia e tokës

Emri/adresa e pronarit/pronarëve të tokës, Numri i identifikimit të pronës sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP⁵ ku janë ndërmarrë (nqse ndryshojnë nga ato të kërkuarit) apo do të ndërmerren aktivitetet (nqse ndryshojnë nga ato të kërkuarit)

Emri dhe mbiemri i pronarit/pronarëve	Shoqeria “Lajthiza Invest” sh.a
Të dhëna për pronësinë e tokës sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP	Zona Kadastrale 2371, me numer pasurie Nr.340
Adresa	Fshati Lajthizë, Nj.Ad Qafe-Mali, Bashkia Fushë-Arrëz, Qarku Shkoder.
Informacion për kontratën e qerasë nëse ka Nr. i kontratës së qerasë nëse kërkuari nuk është pronar i tokës deri në këtë moment	Prona ku do zhvillohet aktiviteti është në pronësi të vetë shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.a .Bashkelidhur kësaj tabele gjëni Certifikatat e Pronësive.

⁵ Zyra e Regjistrimit të pasurive të paluajtshme



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1435599
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit **të Pasurive të Paluajtshme Pukë** Zona Kadastrale Nr. **2371**
 Numri i Pasurisë **340** Volumi **2** Faqe **93**
 Adresa e Pasurisë **Q/F Lajthize B/K Qafe-Mali RRETHI PUKE**
 Lloji i Pasurisë **TRUALL**
 Sipërfaqja Totale **4976(Katerrmijenteqindeshatatedhjetegjashte) m 2**
 Nga kjo : Sa Truall **4976m2** Nga kjo : Sa Ndërtesa **4762m2**
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
Shoqeria " Lajthiza INVEST" sh.a				PUKE Lajthize

- është pronar i _____ i pasurise nr. **340**
 - janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart _____
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi **4976(Katerrmijenteqindeshatatedhjetegjashte) m 2**
 - kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____


Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.


Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 26.07.2017 Nr. 1043


Data e lëshimit të çertifikatës **07.08.2017**


Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
TONIN BALA

Shtojca 2


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PUKË
HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

<p>ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME</p> <p style="text-align: center;">PUKË</p> <p style="text-align: center;">REGJISTRUESI</p> <p style="text-align: center;">TONIN BALA</p> 	<p>A. IDENTITETI I PASURISE</p> <p>ZONA KADASTRALE 2371 NR. PASURISE 340, Vol. 2, Fq 93 INDEKSI I HARTES K-34-65-(181-D) SHKALLA 1:2500 ADRESA E PASURISE :Rrethi PUKË Q/F LAJTHIZE Rr/L P/G SH K Ap</p> <p>B.KUFIZIMET</p> <p>V. 221 L. 231 J. 257 P. 137</p> <p>C.PRONARET</p> <p>Shoqeria " Lajthiza INVEST" sh.a</p>
---	---





Pershkrimi i instalimit, njesite e tij teknike dhe aktivitetet /veprimtarite e lidhura drejtperdrejt me te.

Subjekt, paraqitet ne cilesine e subjektit investitor dhe si subjekti qe do te zhvilloje aktivitetin e Prodhimit ambalazhimit tregtimit te lengjeve te frutave, pije freskuese me gaz dhe pa gaz dhe pije energjike, si dhe Prodhimi i produkteve prej plastike, si aktivitet ne ndihme te ketij te fundit.

Objekti i vleresimit te ketij raporti eshte aktiviteti i Prodhimit ambalazhimit tregtimit te lengjeve te frutave, pije freskuese me gaz dhe pa gaz dhe pije energjike, konkretisht, te cilat jane edhe pijet tradicionale te vendit tone.

Kompania Lajthiza Invest sh.a e themeluar ne vitin 1999, ka investuar pa ndërprerje në një zonë të thellë malore në Veri-Lindje të Shqipërisë, në fshatin Lajthizë, Pukë, Bashkia Fushë-Arrëz me fabrikën e saj të prodhimit dhe ambalazhimit të ujit natyral, por tashme jo vetem uje mineral dhe natyral, aktiviteti do te zhvillohet ne nje objekt ekzistues, i pajisur me:

- Miratim te VNM-se Paraprake, me Nr 87 Prot, Vendim 12, date 11.11.2014.
- Certificate per Vertetim Pronesie me NR 1435599, Zk2371, Nr pasurie 340, Vol 2, Faqe 93, Lloji I mpasurise truall, me siperfaqe totale 4976 m² nga te cilat ndertese 4762 m², ne pronesi te vete shoqerise "LAJTHIZA INVEST" sha

Teknologjia

Deri me tani shoqeria ka prodhuar vetem ujin ne paketime dhe formate te ndryshme, tashme subjekti do te shtojte edhe dy linja.

- **Linjen e prodhimit te pijeve freskuese (joalkolike, lengjeve te frutave)** me gaz edhe pa gaz, si edhe ate te pijeve energjike, si dhe
- **Linjen e prodhimit te plastikës**, ky I fundit si aktivitet ne funksion te atij te prodhimit te pijeve , me qellim ambalazhimin dhe tregtimin e tyre.

Fabrika e ujit natyral Lajthiza është ndërtuar në lartësinë 1200 m mbi nivelin e detit, ndërsa burimi rrjedh nga një masiv malor 1600 m mbi nivelin e detit, me një strukturë shkëmbore magmatike. Burimi Natyror i Ujit klasifikohet si Ujë – i pasur dhe i balancuar me minerale dhe bakteriologjikisht I certifikuar dhe me cilësi të veçanta për shëndetin.

Linjen e prodhimit te pijeve freskuese(joalkolike, lengjeve te frutave) me gaz edhe pa gaz, si edhe ate te pijeve energjike

Industria e pijeve joalkoolike është shumë dinamike dhe konkurruese. Prodhimi i pijeve joalkoolike përfshin një process kompleks që transformon lëndët e para në pije të gazuara dhe me shije që i gjeni të ambalazuara ose të konservuara në dyqanet me pakicë.

Pijet e gazuara njihen zakonisht si pije joalkoolike. Ato perbehen nga uji, agjentë ëmbëlsues, agjentë aromatizues dhe dioksid karboni. Këto pije vijnë në shumë shije si: kola, mango, portokall molle, pjeshke etj.

Lëndët e para të përdorura në prodhimin e pijeve joalkoolike

Shtojca 2

Faza e parë e procesit të prodhimit të pijeve joalkoolike përfshin përzgjedhjen dhe përgatitjen e kujdesshme të lëndëve të para. Cilësia e këtyre përbërësve përcakton shijen, konsistencën dhe jetëgjatësinë e produktit përfundimtar.

Procesi i Prodhimit

Operacionet në impiantet e reja moderne janë shumë të automatizuara për pijet joalkoolike, që do të thotë se qëndrueshmëria, efikasiteti dhe higjiena nuk do të rrezikohen. Në fakt, ka disa faza në të gjithë procesin:

1. Trajtimi i ujit:

Uji për sode duhet të jetë më i pastër për të lejuar cilësinë e produktit. Filtrimi i ujit përmes fazave të ndryshme të pastrimit për largimin e papastërtive, kimikateve dhe mikrobeve. Metodat e zakonshme përfshijnë:

- Filtrimi
- Osmozë e kundërt
- Trajtimi UV
- De-klorifikimi

2. Përzierja:

Pas trajtimit të ujit, lëndët e para duhet të përzihen së bashku për të prodhuar shurupin e pijeve joalkoolike. Këto shurupe zakonisht përmbajnë ujë, ëmbëlsues, aromatizues dhe acide. Sasitë maten dhe shtohen në enë të mëdha të quajtura "depozita për përzierje". Parametrat e temperaturës dhe pH kontrollohen me kujdes për të mundësuar trazimin e duhur të rezervuarëve, të cilët zakonisht janë të pajisur me trazues. Kjo siguron që përzierja të shpërndahet në mënyrë uniforme dhe produkti përfundimtar të ketë konsistencë. Në prodhimin e pijeve joalkoolike me shije frutash, lëngjet e koncentruara të frutave ose shurupet përzihen me ujë dhe përbërës të tjerë për të arritur profilin e dëshiruar të shijes. Formulimi duhet të ndiqet me germë për të përmbushur shijen dhe specifikimet e cilësisë së markës së specifikuar.

3. Karbonizimi:

Procesi i karbonizimit është një hap thelbësor në prodhimin e pijeve joalkoolike. Lëngu mbushet me gaz CO₂, duke përdorur një proces që kërkon presion të lartë për të mbajtur gazin të tretshëm derisa të hapet shishja, dhe më pas gazi del, duke prodhuar gazin që lidhet me pijen e gazuar. Sasia e CO₂ e shtuar varet nga lloji i pijes sode që përgatitet. Për shembull, kolat prirën të jenë më të gazuara sesa pijet freskuese me shije frutash. Procesi i karbonizimit zhvillohet në një pajisje të quajtur karbonator, ku pija e gazuar ftohet për të rritur aftësinë të tretës së CO₂.

4. Mbushja dhe paketimi:

Në karbonizimin e sodës, ajo është gati për procesin e mbushjes ose konservimit. Është një proces që duhet bërë shpejt dhe me efikasitet për të shmangur humbjen e tij në sodën e gazuar. Linjat moderne të mbushjes kanë aftësinë për të mbushur disa qindra shishe ose kanaçe në minutë. Mbushet në shishe ose kanaçe të dezinfektuara nën presion për të parandaluar ikjen e CO₂. Pas mbushjes, ajo mbyllet në kontejnerë me kapak, të cilët sigurojnë që karbonizimi të mbetet në pije deri në momentin e konsumimit. Faza e fundit e procesit të prodhimit përfshin paketimin dhe etiketimin e produkteve që janë gati për dërgesë. Kjo përfshin shisheet me mbështjellje, organizimin e kanaçeve në kartona ose përgatitjen e paletave për dërgesë.

Ruajtja dhe riciklimi i ujit:

Uji përfaqëson komponentin vendimtar në prodhimin e pijeve joalkoolike; megjithatë, ai është gjithashtu një burim që kërkon menaxhim të qëndrueshëm. Objekte të shumta kanë krijuar iniciativa për ruajtjen e ujit që synojnë reduktimin e mbetjeve, të cilat përfshijnë teknologjitë për riciklimin dhe ripërdorimin e ujit. **Sistemet me qark të mbyllur, u mundësojnë impianteve të rikuperojnë ujin e përdorur në çdo proces pastrimi ose ftohjeje dhe mundësojnë pastrimin për ripërdorim. Në përgjithësi, kjo redukton konsumin e ujit dhe ndikimin e përgjithshëm negativ mjedisor të prodhimit.**

Efikasiteti i Energjisë:

Konsumi i energjisë është fusha tjetër e rëndësishme që prodhuesit e pijeve joalkoolike po inovojnë për të reduktuar gjurmën e tyre. Impiantet moderne përmbajnë pajisje me efikasitet energjie - mikserë me energji të ulët dhe karbonatorë me efikasitet të lartë - të cilat reduktojnë ndjeshëm përdorimin e energjisë përmes procesit të prodhimit. Për më tepër, impiante të tilla përdorin panele diellore dhe forma të tjera të energjisë së rinovueshme për t'i fuqizuar ato. Impiantet kanë optimizuar gjithashtu proceset e tyre nëpërmjet reduktimit të emetimeve të transportit për shkak të efikasitetit të zinxhirit të furnizimit dhe uljes së numrit të dërgesave dhe dërgesave të nevojshme për të minimizuar gjurmën e karbonit që lëviz lëndët e para dhe produktet e gatshme.

Paketim

Paketimi i pijeve joalkoolike është një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis. Industria ka arritur suksese të rëndësishme në zhvillimin e llojeve alternative të paketimeve që janë më të qëndrueshme, mes tyre përdorimi i materialeve të ricikluara për shishet, minimizimi i trashësisë së shisheve plastike dhe promovimi i plastikës së biodegradueshme ose me bazë bimore. “Kompania Lajthiza Invest” sh.a ka një cikël të mbyllur të prodhimit, nga:

- Injektimi:

Lajthiza realizon një proces me teknologji të lartë injeksioni në PET dhe HDPE, me makineri të prodhuara nga kompania o NESTAL (Zvicër) dhe KRAUSS MAFFEI (Gjermani)

Netstal PET-Line ofron përputhshmërinë më të gjerë me kallëpet ekzistuese të hyrjes anësore dhe stacionet e ftohjes pas mykut. Sistemi impresionon me produktivitetin superlativ, efikasitetin e jashtëzakonshëm të energjisë, përpunimin e optimizuar të riciklimit PET dhe një njësi funksionimi intuitive.

- Linjat e prodhimit janë teknologjia më e avancuar për proceset e fryrjes, mbushjes, taposjes dhe paketimit, pothuajse që të gjitha të prodhuara nga kompania KRONES AG (Gjermani)

Një linjë mbushjeje e personalizuar për çdo lloj kontejneri

Qoftë për shishe qelqi, kontejnerë PET ose kanaçe, për mbushje, etiketim ose paketim, për ujë, birra ose pije joalkoolike – Krones ofron një zgjidhje të personalizuar të sistemit për çdo hap të procesit, çdo lloj kontejneri dhe çdo kategori pijesh.

Portofoli i gjerë përfshin të gjitha makineritë e nevojshme për prodhimin e pijeve: nga formuesit me fryrje për kontejnerët PET dhe shpëlarësit për shishe e qelqit dhe kanaçet, deri te mbushësit e përshtatshëm për çdo lloj

Shtojca 2


kontejneri dhe etiketuesit për të gjitha variantet konvencionale të etiketimit dhe dekorimit, si dhe të gjitha sistemet me fund të thatë.

Linjat e shisheve për kontejnerët PET

Është materiali më i përdorur për paketimin e pijeve: PET. Arsyet për këtë janë të dukshme: kontejnerët PET janë, nga njëra anë, jashtëzakonisht të lehta dhe të lehta për t'u trajtuar dhe, nga ana tjetër, janë jashtëzakonisht të qëndrueshme dhe të forta. Por ky lloj kontejneri ofron edhe avantazhe të pakrahasueshme në prodhimin e pijeve: Si lëndë e parë, PET mund të prodhohet me shumë efikasitet, gjë që jo vetëm ka një ndikim pozitiv në kostot e prodhimit, por rrjedhimisht edhe në çmimin e shitjes së produkteve përfundimtare. Në të njëjtën kohë, kontejnerët PET mbrojnë mallrat e ndjeshme si pijet, ushqimet dhe medikamentet kundër oksigjenit, mikrobeve dhe ndikimeve të tjera të dëmshme.

- Linja Bardi, ka kapacitet të lartë të mbushjes së ujit në formatin 19 L

Trevi 5G, Mbushja e monoblokut për prodhim deri në 2.000 bph nga 5 Lt në 5 gallon. Karakteristikat Trevi Twin janë transferuar gjithashtu në një bllok linear, për prodhim më të vogël deri në 2.000 bph.



Bardi mund të ofrojë 2 zgjidhje alternative:

Në rast të ushqyerjes manuale të shisheve, mund të ofrojë një shpëlarës i cili mund të sigurojë një veprim të fortë pastrimi në shishe, përmes:

Një trajtim i parë i sterilizimit, nëpërmjet ujit të ozonuar

Një shpëlarje e dytë përmes ujit mbushës ose ajrit të filtruar

Në rast të fryrjes së drejtpërdrejtë të shishes në linjë, mund të furnizojë monoblokin pa asnjë shpëlarës, por me një transportues tuneli të mbyllur dhe nën presion.



Mbushësi

Mbushësi Bardi, sipas dizajnit ultra të pastër, ka karakteristikat e mëposhtme:

Procesi i mbushjes shmang kontaktin midis valvulës dhe qafës së shishes (rreziku i transferimit të kontaminimit).

Valvula mbushëse dhe të gjitha tubacionet, valvulat etj. në kontakt me produktin kanë një dizajn sanitar dhe të punuar nga aisi 316 S.S.

Procesi i mbushjes kontrollohet në mënyrë elektronike, kështu që duhet të garantojë saktësinë e mbushjes dhe të kufizojë konsumin e ujit.

Kabineti nuk paraqet rrugë pa krye, sipas kërkesave më strikte të projektimit të higjienës.

Kabineti mbushës është i pajisur me rrjedhje ajri me presion të tepërt. Duhet të garantohet një filtrim ajri minimal i klasës 1000, në mënyrë që të mbrohet mjedisi mbushës nga ndotja e jashtme e ambientit. Sipas kërkesës, disponohen filtra të certifikuar të klasës 100 (shihni fotot më poshtë). Nëse ka, shpëlarësi dhe mbushësi janë bllokuar për të shmangur ndotjen e mundshme të shisheve të pastra që udhëtojnë nga dalja e shpëlarësit në zonën e mbushjes.

Jashtë kabinetit janë instaluar të gjitha ingranazhet mekanike dhe pneumatike.

Të gjitha pjesët dhe sipërfaqet në kontakt me produktin janë të rregulluara paraprakisht për trajtimin e sterilizimit CIP (pastrimi në vend) me 3 ose 5 hapa; sistemi CIP mund të jetë automatik ose gjysmë automatik dhe mund të funksionojë me zgjidhje të nxehtë ose të ftohtë



Kapaku

Kapaku elektronik i vidhave dallohet për shkak të thjeshtësisë dhe saktësisë së funksionimit.

Sistemi nuk kërkon yje, kthetra mekanike ose mekanizma ngritjeje komplekse.

Çift rrotullimi i mbylljes mund të vendoset nga ekrani me prekje; konverteri vektorial i frekuencës lejon menaxhimin e tij me saktësi të lartë.

Pjesët e trajtimit për të lëvizur shishen në makinë janë reduktuar në minimum, në mënyrë që koha e ndërprerjes së ndërrimit.



Ndryshimi i ri mbi sistemin

Kjo makinë pajiset me një sistem të ri për ndryshimin e madhësisë së shisheve i cili:

Shtojca 2

Lejon përdorimin e valvulës mbushëse dhe të gjithë tubacionet, valvulat etj. në kontakt me produktin me dizajn sanitar dhe të bërë nga AISI 316 S.S. (pa tubacione fleksibël)

Është i menjëhershëm, mund të trajtohet lehtësisht përmes PLC dhe nuk përfshin humbje kohe


Nuk kërkon përpjekje fizike ose njohuri teknike



- Sistemi i filtrimit të ujit është sistem i integruar 3M (SHBA)

Mbushja kryhet vetëm me gravitet, direkt nga burimi e në filtër dhe pastaj në shishe pa ia prishur strukturën ujit, pa parë në asnjë moment dritën e diellit, pa përdorur asnjë lloj pompe, pa trajtimin e ujit, pa korrektimin e tij, absolutisht pa ndotjen e ujit në sajë të përdorimit të tubacioneve inoksi hermetike.

Ky proces siguron që: “Lajthiza Premium Water” të ketë cilësi shumë të mirë të ujit.



Linja Tetra Pak, e cila është një teknologji superiore dhe e avancuar, është instaluar në Pukë, në fabrikën e prodhimit të ujit Lajthiza® në Lajthizë, Pukë. Kjo teknologji prodhimi siguron jo vetëm paketim modern dhe ekonomik deri më tani, por edhe kontrollin e të gjitha fazave të prodhimit.

Paketimi Tetra Pak, ruan temperaturën e ftohtë më gjatë, ruan vetitë organoleptike natyrore, mbron vlerat ushqyese që uji mbart dhe është lehtësisht i riciklueshëm. Është projektuar të jetë lehtësisht për t'u marrë kur

Shtojca 2

jeni në lëvizje. Uji mineral natyral Lajthiza® buron nga lartësia dhe qëndron i paprekur pa u ndikuar nga rrezet e diellit derisa të hapet. Paketimi Tetra Pak®, ka marrë miratimin nga Shoqata Suedeze e Reumatizmit.

Flota

Lajthiza mbulon 100% tregun e Republikës së Shqipërisë. Shitja, transporti, marketingu bëhen vetë nga Lajthiza.

Transportimi i ujit kryhet direkt nga fabrika e prodhimit Pukë për në magazinat e saj në Tiranë, Durrës, Kavajë dhe deri tek distributorët që gjenden në të gjithë Shqipërinë.

Kompania Lajthiza® përdor mjete të tonazhit të lartë, siç janë Trajlerat e markës Actros (Mercedes-Benz).

Shitja bëhet nga vetë Lajthiza® duke përdorur mjete tip furgoni me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton, të markës Mercedes – Benz.

Flota për shitjen përbëhet nga rreth 120 furgona të cilët janë kudo në Tiranë, Durrës, Kavajë, ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga Distributorët, të cilët kanë furgona me logon zyrtare të “Lajthiza”.

Formatet e Lajthizës

1. Pije Freskuese te Gazuara ne paketim PET;

- Paketim 0.33L, Cola, Mango dhe Orange.

2. Pije Freskuese te Gazuara ne Kanace;

- Paketim 0.33L, Orangeade, Lemonade, Cola, Tonic Water, Rose;

3. Pije Energjike ne Kanace “OX”;

- Paketim 0.25L, OX Regular dhe OX Passion Fruit.

4. Uje Aromatik ne Paketim Tetrapak:

- Paketim 0.5L, shije Molle, Portokall dhe Limon.

5. Uje me Vitamina ne paketim PET:

- Paketim 0.33L, shije Pjeshke, Portokall dhe Molle.

6. Uje Tonic ne Paketim PET;

- Paketim 0.33L.

7. Uje Natyral Mineral ne paketim PET, Qelq dhe Tetrapak;

- Paketim PET 0.5L, 1.5L, 2L, 2.5L dhe 5L.
- Paketim Qelq 0.25L, 0.33L, 0.5L, 0.75L.
- Paketim Tetrapak 0.5L, 0.75L dhe 1L.
- Paketim Polikarbonat 5-Gallon.

8. Uje i Gazuar ne paketim PET dhe Qelq;

- Paketim PET 0.5L dhe 1.5L.
- Paketim Qelq 0.25L, 0.33L, 0.5L, 0.75L.

9. Uje Natyral Mineral ne paketim Tetrapak;

- Paketim 0.5L, 0.75L, 1L.

Shtojca 2



Uje Lajthiza®Me Arome
Portokalli 0.5L



Uje Lajthiza®Me Arome
Limoni 0.5L



Uje Lajthiza®Me Arome
Molle 0.5L



Uje me vitamina shije
molle



Uje me vitamina shije
peshke



Uje me vitamina shije
portokall



Uje Tonik



Lajthiza® 0.5L



Lajthiza® 1.5L



Lajthiza® 2L



Lajthiza® 2.5L



Lajthiza® 5L



Lajthiza® 19L



Ujë + Dispencer



Lajthiza® me gaz 0.5L



Lajthiza® me gaz 1.5L



Lajthiza®Qelq natyral
0.75L

Shtojca 2



Çertifikimet e Ujit Lajthiza

Uji “Lajthiza” është i kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme nga Organet shtetërore të Higjenës dhe të Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, është i çertifikuar nga kontrolli i cilësisë (i detyrueshëm) HACCP si dhe i çertifikuar dhe kontrolluar nga (SGS) Instituti prestigjioz “Fresenius”, Munchen, Gjermani (duke iu përmbajtur standardeve Europiane të ruajtjes së burimit të ujit, ruajtjen e florës së zonës, përzgjedhjen e teknologjisë si dhe mbushjen e ujit në mënyrë higjenike duke ruajtur standardet e këtij uji për konsum në tregun e brendshëm dhe eksport në tregun European dhe Gulf).

Patentë: Ujë Natyral Burimi “Lajthiza”. Pronësi Industriale.

Nr.Licensë: LN-3104-03-2011. Lëshuar nga “Ministria e Ekonomisë dhe Energjitikës”. (QKL)

Menaxhimi i mbetjeve organike

Ne kete aktivitet gjenerohen Mbetje qe vijne nga larja, pastrimi dhe perpunimi mekanik i lendeve te para me kodin 02 07 01, si edhe Lende te papershtatshme per konsum apo perpunim qe identifikohen me kodin 02 07 04. Menyra e menaxhimit te tyre eshte jashte instalimit dhe mendohet te realizohet ne kete menyre: do te behet Transportimi dhe depozitimi i tyre ne nje ambient te pershtatshem per ricikilimin e tyre nepermjet biodegradimit, kompostimit te lendes organike dhe prodhimit te plehut organik per bujqesi. Vendi ku do te depozitohen do te percaktohet ne nje faze te mevonshme.

Riciklimi i mbetjeve biologjike, eshte me kosto te ulet, por me vlere te larte perfituese pasi pleherohet toka me elemente ushqyes organike dhe minerale, duke shmangur ose reduktuar pleherimin kimik dhe duke ulur rrezikun e ndotjes se mjedisit bujqesor. Pleherimi i vreshtave, pemeve frutore me keto lloj mbetjesh organike eshte i pershtatshem, pasi i rikthehen tokes ne vija te pergjithshme te njejtat elemente ushqyes qe bima merr dhe qe ka nevojte per te siguruar nga toka.

Mbetjet urbane grumbullohen dhe hidhen ne kontenierin e mbetjeve te ngurta urbane, ku pastrohen cdo dite nga firma pastruese e zones. Ambalazhe (duke perfshire mbetjet e paketuara urbane), me kodin 15 01. Depozitim ne kontenierin e mbetjeve te ngurta urbane te zones.

SHKARKIMET

Shkarkimet ne uje

Ky aktivitet nuk ka shkarkime industriale ne uje. Ujerat qe perdoren jane vetem ato te ambienteve higjensanitare perfshi edhe ujerat e larjes se eneve te depozitimit te frutave. Procesi i prodhimit te pijeve freskuese nuk shoqerohet me shkarkime te ujerave te perdorur.

Emetimet ne ajer

Ky aktivitet nuk shoqerohet me ndikim ne ajer, persa I perket teknologjise se prodhimit te pijeve freskuese. Ndikimi ne ajer vjen vetem si pasoje e levizjes se automjeteve per shperndarjen e produktit final qe prodhohet ne kete aktivitet.

Zhurmat dhe vibrimet

Ky aktivitet nuk shoqerohet me zhurma ne mjedis. Nuk ka as pajisje as makineri me elektromotorre apo lende djegese, nuk prodhohen zhurma.

Ndikimi ne toke

Nuk ka ndikim ne toke, pasi aktiviteti funksionon ne nje ambient te mbyllur dhe te izoluar me beton nga toka. Nuk ka punime ne toke, nuk ka shkarkime ne toke.

Ndikimi ne Biodiversitet

Kjo zone nuk ben pjese ne zonat e ndjeshme te zonave te mbrojtura me ligj, as lloji i aktivitetit nuk ndikon ne biodiversitet.

Ndikimi ne Mjedisin Social

Ndikimi i ketij projekti ne mjedisin social, do te jete pozitiv persa i perket punesimit, sherbimit te prodhimit e shtijes se pijeve joalkoolike me cmime dhe cilesi te konkurueshme.

Mbetjet e prodhuara

Mbetjet e ngurta qe do te prodhohen do te jene mbetjet urbane nga aktiviteti human. Nuk vleresohet aktivitetet me mbetje te ngurta te rrezikshme.

Nuk ka pajisje qe punojne me rrezatim jojonizues, as pajisje qe punojne me rrezatim jonizues.

Energjia elektrike eshte e siguruar me kablo te veshura.

Reduktimi i shkarkimit dhe sistemet e kontrollit

- Ne ambient te ruhen kushte te larta higjenike te prodhimit te produktit ushqimor, pije joalkolike.
- Te prodhohet produkt cilesor dhe ne asnje menyre te mos perdoren ingrediente, ngjyrues apo substanca te tjera artificiale, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e konsumatoreve.
- Subjekti te ruaj parametrat e lejuar te elementeve perberes te pijeve freskuese.

Monitorimi

Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit te Mjedisit

Rolin dhe pergjegjesine kryesore te monitorimit dhe rehabilitimit te mjedisit e ka:

Investitori, ose ne rast delegimi te zbatimit te punimeve, subjekti ndertues/nenkontraktor.

Institucionet pergjegjese per mbikqyrjen jane: Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM), Drejtoria Rajonale e Mjedisit (DRM), Inspektoriati Shteteror i Mjedisit, Pyjeve, Ujerave dhe Turizmit (ISHMPUT), Njesia e Qeverisjes Vendore (NJQV), Inspektoriati Kombetar i Mbrojtjes se Territorit (IKMT), si dhe vete subjekti investitor ose nenkontraktori i zgjedhur per kete qellim.

Monitorimi i elementeve mjedisore.

Monitorimi i cilesise se mjedisit dhe i nivelit te elementeve ndotes se tij, shkarkimet ne ajer, ne uje, ne toke dhe demtimi i mjedisit biologjik, kryhet sipas disa kriterave shkencore per sa i perket vrojttimeve, mbledhjes dhe analizimit te mostrave te ujit dhe te tokes, ndersa per sa i perkete ndotjes se ajrit ai monitorohet direkt ne terren. Procesi i monitorimit synon mbledhjen e te dhenave te nevojshme per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv.

Shtojca 2

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- Per te siguruar informacione midis lidhjes se kushteve te burimeve te ndotjes dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor ose ekonomik, me synim per te marre masat e nevojshme per reduktimin e shkarkimeve dhe permiresimin e cilesise se elementeve te mjedisit.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore te hartuara dhe te ndermarra.

Procesi i monitorimit ne rang individual, sipas ligjit per mbrojtjen e mjedisit, eshte detyre e shoqerise investitore/operatorit te pajisur me leje mjedisi ose e nenkontraktorit te zgjedhur per kete qellim, per elementet ne te cilat ai ndikon. Sipas VKM Nr.1189. date 18.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e programit kombetar te monitorimit te mjedisit" pikat c1, c2, c5, c6, c7, c8 mund te monitorohen nga vete investitori. Monitorimi te kryhet per shkarkimet ne ajer, zhurmat, cilesine e burimeve ujore, si dhe per punimet e rehabilitimit.

Bazuar ne Ligjin Nr 10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, Kreu VI, Monitorimi i Gjendjes se Mjedisit, Seksioni 2, Monitorimi i Perputhshmerise, Neni 44, Detyrimet e operatorit per monitorimin e perputhshmerise jane:

- Operatori i veprimtarive, te perfshira ne kategorite A, B dhe C, te referuara ne nenin 29 te ketij ligji, monitoron shkarkimet e veprimtarise se tij, ne perputhje me dispozitat e legjislacionit per lejet e mjedisit dhe kushtet e percaktuara ne lejen perkatese te mjedisit.

- Operatori i referuar ne piken 1 te ketij neni monitoron burimet e shkarkimit te veprimtarise se vet dhe kryen monitorime te tjera, duke perdorur pajisje dhe instrumente te miratuara, permes procedures per verifikimin e matjeve, te parashikuara ne legjislacionin e posac;em dhe ne pajtim me kushtet e percaktuara ne lejen perkatese te mjedisit, si dhe mban keto pajisje e instrumente ne nje gjendje te pershtatshme pune.
- Operatori mund te kryeje monitorimin nepermjet pajisjeve dhe instrumenteve te akredituara qe ai disponon ose nepermjet laboratoreve te specializuar e te akredituar.
- Rezultatet e vetemonitorimit u jepen autoriteteve perkatese ne perputhje me legjislacionin per lejet mjedisore dhe me kushtet e perfshira ne lejen perkatese mjedisore.

Frekuenca e monitorimeve do te percaktohet sipas kuadrit ligjor, ku operatori i nje leje mjedisi te tipit B, duhet te kryej vetemonitorimin e ndikimeve ne mjedis te aktivitetit dhe i raporton ato rregullisht te pakten dy here ne vit prane AKM-se. Gjithashtu, raportimi periodik permban edhe informacion per masat e marra per mbrojtjen e mjedisit.

Aspektet mjedisore dhe teknikat me te mira te disponueshme

"Teknikat me te mira te disponueshme (TMD)" eshte stadi me efektiv dhe me i perparuar i zhvillimit te veprimtarive dhe te metodave te operimit te tyre. Ky stad tregon se sa te pershtatshme jane praktikisht teknikat e vecanta per te siguruar, ne parim, bazen per te percaktuar vlera kufi te shkarkimeve, te tilla qe te parandalojne dhe, kur nuk eshte praktikisht e mundshme, te pakesojne shkarkimet ne pergjithesi dhe ndikimin mbi mjedisin ne teresi.

Per qellime te ketij perkufizimi, me termat e meposhtem kuptojme:

- "Teknike" eshte teknologjia dhe menyra me te cilen instalimi eshte projektuar, ndertuar, mirembajtur dhe cmontuar;

- "Teknike e disponueshme" jane teknikat e zhvilluara ne ate nivel qe mundeson perdorimin e tyre, ne sektorin perkates industrial, me rezultate te mira ekonomike e teknike. Vleresimi i teknikave merr parasysh kostot dhe perparsite, pavaresisht nga fakti nese ato teknika perdoren apo prodhohen ne Republiken e Shqiperise, per sa kohe ato jane te arritshme nga perdoruesi; - "Me e mire", ne lidhje me teknikat, eshte teknika me efektive per arritjen e nje niveli te la rte te pergjithshem te mbrojtjes se mjedisit ne teresi.

Aktiviteti objekti i kesaj leje mjedisore, sipas deklarimit te investitorit, ka dhe zbaton teknikat me te mira te disponueshme per kete lloj instalimi.

Programi i permiresimit

Subjekti investitor, duhet te kujdeset per nje mjedis te pastër, te rregullt, teper higjenik, te sigurte dhe te pajisur me infrastrukturen dhe posterat sensibilizues perkates per kushtet teknike dhe per mjedisin. Duke qene se aktiviteti do te kryhet ne nje ambient te mbyllur, nuk mund te vleresohet ky kapitull per rehabilitimin e mjedisit.

Pershkrimi i masave te tjera parandaluese te planifikuara

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori per mbarefunksionimin e aktivitetit dhe ruajtjen e mjedisit fizik e biologjik.

- Ne ambient te ruhen kushte te larta higjenike te prodhimit te produktit ushqimor, pije joalkolike (freskuese)
- Te prodhohet produkt cilesor dhe ne asnje menyre te mos perdoren ingrediente, ngjyrues apo substanca te tjera artificiale, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e konsumatoreve.

Rehabilitimi, nderprerja e veprimtarise, rifillimi dhe kontrolli pas nxjerrjes nga perdorimi

Nderprerja perfundimtare e veprimtarise, apo transferimi i aktivitetit ne nje vendodhje tjeter, sjell si rrjedhoje nevojen per mbylljen dhe rehabilitimin e mjedisit. Ne lidhje me kete hartohet nje plan per mbylljen dhe rehabilitimin qysh ne faze te hershme kur operatori pajiset me leje mjedisi dhe e rishikon ate ne momentin e mbylljes dhe zbatimit te ketij plani.

Ne lejen mjedisore te tipit B, ky proces parashikohet ne kushtin nr. 14 te lejes se mjedisit. Plani i mbylljes dhe rehabilitimit konsiston ne keto procese:

- Cmontimi i pajisjeve/makinerive,
- Transporti i tyre ne vendodhjen e re, ose per ne pikat e riciklimit/asgjesimit ne rast se nuk do te riperdoren.
- Instalimi ne vendodhjen e re ne rast se aktiviteti transferohet.

Shtojca 2

Objekti ne te cilin do te zhvillohet aktiviteti, eshte objekt ekzistues, eshte ne gjendje te mire dhe plotesisht funksional, nuk do te kryhet rikonstrukcion dhe ne rast cmontimi, nuk do te kete prishje te objektit dhe rehabilitim te mjedisit natyror.

Gjate zhvillimit te aktivitetit subjekti nuk do te kryej asnje nderhyrje ne strukturen e objektit.

Plani i menaxhimit te mbetjeve

Objekti i ketij aktiviteti eshte prodhimi i pijeve freskuese, joalkoolike, konkretisht

Nuk ka perfshirje teknologjie, nuk ka mbetje te rrezikshme, nuk ka shkarkime te ujerave industriale. Energjia elektrike eshte material ndihmes kryesor, por edhe materialet e tjera si paketimi etiketimi etj.

Ne kete aktivitet gjenerohen Mbetje qe vijne nga larja, pastrimi dhe perpunimi mekanik i lendeve te para me kodin 02 07 01, si edhe Lende te papershtatshme per konsum apo perpunim qe identifikohen me kodin 02 07 04. Menyra e menaxhimit te tyre eshte jashte instalimit dhe mendohet te realizohet nepermjet kontraktimit te subjekteve te licensuara.

Vendi ku do te depozitohen do te percaktohet ne nje faze te mevonshme.